

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Biljana Rexhiq, kryetare e kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Gani Zabeli, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Përparim Zeka, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të shmangies nga sigurimi i mjeteve të jetesës nga neni 213 par.1 të KPK-së duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë dhe ankesës së mbrojtësit të akuzuarit av. T.B., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.257/2011 të datës 10.05.2018 në seancë ne kolegjit të mbajtur me 06.08.2018 mori këtë :

## A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pa bazuara ankesat, e prokurorisë Themelore në Gjakovë si dhe e mbrojtësit të akuzuarit F.B., av. T.B., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.257/2011, të dt.10.05.2018, **vërtetohet**.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.257/2011, të dt.10.05.2018, është shpallur fajtor i akuzuari F.B., për shkak të veprës penale të shmangies nga sigurimi i mjeteve të jetesës nga neni 213 par.1 të KPK-së, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditëve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në pajtim të nenit 47 të KPK-së me kërkesën dhe pëlqimin e të akuzuarit, si dhe në praninë e mbrojtësit të tij dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditëve zëvendësohet në dënimin me gjobë në shumën prej 1300 (njëmijë e treqind) euro , të cilin dënim obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Poqë se i akuzuari dënimin me gjobë nuk e paguan brendas afatit të caktuar, atëherë i njëjti zëvendësohet me dënimin me burgim si me larte.

E dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sa do që të jenë ato sipas llogarisë së bere në arkë të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor kanë ushtruar ankesë:

-Prokuroria Themelore në Gjakovë për shkak të vendimit mbi dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i ashpër,

-mbrojtësi i të akuzuarit F.B., av. T.B., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve të ligjit penal si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje, si dhe

- i akuzuari F.B., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve të ligjit penal si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/II.nr.676/2018, të datës 29.06.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesat e ushtruara, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë të aprovohet si e bazuar, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i ashpër, kurse sa u përket ankesave, të mbrojtësit të akuzuarit av. T.B., dhe asaj të akuzuarit, të njëjtat të refuzohen si të pa bazuara.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesat e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

**Ankesat, e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, mbrojtësit të akuzuarit, av. T.B. dhe e të akuzuarit F.B., nuk janë të bazuara.**

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, av.T.B. dhe të akuzuarit F.B., aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, pa dhënë ndonjë arsyetim përkitazi me bazën ankimore për të cilën e kanë ankimuar aktgjykimin, mirëpo kolegji i kësaj gjykate e ka vlerësuar të njëjtin sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394 të KPPK, për të cilat arsye përkujdeset sipas detyrës zyrtare, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë, se dispozitivi i të njëjtit është i qartë, nuk është në kundërshtim me vetveten si dhe me arsyetimin, ngase përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare të cilat e karakterizojnë veprën penale shmangien nga siguri i mjeteve të jetesës nga neni 231 par.1 të KPK-së si dhe i njëjti është përpiluar në kuptim të nenit 370 të KPPK-së ngase përmban formën e aktgjykimit me shkrim sepse gjykata në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit dhe ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat faktet dhe për çfarë arsye konsiderohen të vërtetuara si dhe ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjedhjes së çështjes dhe ka vërtetuar ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale së të akuzuarit, andaj kolegji i kësaj gjykate është i bindur se aktgjykimi si i tillë është i drejtë dhe i bazuar me ligj.

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, av. T.B. dhe ankesës së të akuzuarit F.B., aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljes së ligjit penal. Dhe përkundër asaj që nuk janë paraqitur arsyet, kolegji i kësaj gjykate të njëjtin e ka vlerësuar përkritazi me ankesat e ushtruara dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal nga neni 385 të KPPK-së, sepse vepra penale për të cilën është akuzuar i akuzuari është e paraparë me ligjin e aplikueshëm, se nuk eksitojnë rrethanat që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, sepse kryerja e të njëjtës është në vazhdimësi, dhe se gjykata e shkallës së parë në kuadër të kompetencës ligjore, andaj aktgjykimi është i pranueshëm edhe për kolegjin e kësaj gjykate.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit për dënimin, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ka vlerësuar rrethanat lehtësuese edhe ato rënduese, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar, gjendjen ekonomike të akuzuarit, pranimin e fajësisë nga ana e tij, pendimin e tij të thelle për kryerjen e veprës penale, premtimin e tij se në të ardhmen nuk ka me ra në kundërshtim me ligjin si dhe sjelljen korrekte gjatë gjykimit. Gjithashtu ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese sikurse është pesha e veprës penale, motivin për kryerjen e së njëjtës, dhe të akuzuari i ka shqiptuar dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Qëndron bindja në prokurori, se rrethanat rënduese nuk janë vlerësuar në mënyrë të duhur sepse i akuzuari në mos përmbushjen e obligimit të caktuar sipas vendimit të gjykatës ,nuk përkujdeset për fëmijët duke mos e bërë pagesën për ushqimi, përkundër asaj që i njëjti punon në botën e jashtme dhe nuk mund t'iu ik obligimeve ndaj fëmijëve, ashtu që jemi të mendimit se me dënimin e shqiptuar nuk mund të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit i paraparë me ligj.

Sipas ankesës së mbrojtësi të akuzuarit, av.T.B. dhe të akuzuarit F.B., aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ankimohet për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se vendimi mbi dënimin është i ashpër.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesat e ushtruara, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave e të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, ashtu që kolegji pas vlerësimit të ankesave të ushtruara kundër aktgjykimit të shkallës së parë, vie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se ka patur sjellje korrekte në gjykatë, se ka premtuar se në të ardhmen nuk ka me ra në kundërshtim me ligjin, gjithashtu ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese, sikurse është motivi i kryerjes së veprës penale, andaj në prani të këtyre rrethanave e duke mos gjetur ndonjë rrethanë lehtësuese a[po rënduese sikurse pretendohet në ankesat e ushtruara, kolegji i kësaj gjykatë është i bindur se me dënimin e shqiptuar sikurse ne dispozitiv të aktgjykimit do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra

penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1. nr.669/2018, të datës 06.08.2018**

**Bashkëpunëtori profesional**  
**Përparim Zeka**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit**  
**Biljana Rexhiq**

**Gani Zabeli**